



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

PROÇESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Ditën e premte, datë **6.12.2024**, ora 14:00 në ambjentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u mbajt mbledhja e tretë e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për vitin 2024. Anëtarë të pranishëm në mbledhje ishin:

Për anëtarët përfaqësues të **institucioneve publike**:

1. Znj. Denada Seferi –Zv/Ministre - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Z. Tedi Dobi – Zv/Ministër - Ministria e Drejtësisë
3. Znj. Ilva Gjuzi – Zv/Ministre - Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
4. Znj. Enkeleda Kuçi - Ministria e Financave
5. Znj. Berla Huta - Ministria e Financave
6. Z. Arian Jaupllari – Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
7. Z. Andi Kananaj – Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
8. Znj. Anxhela Kenaj - Ministria e Drejtësisë
9. Znj. Gentiana Dervishi - Ministria e Drejtësisë

Për anëtarët përfaqësues të **shoqërisë civile** në Këshill:

1. Z. Vladimir Thano –N/Kryetar i Këshillit
2. Z. Indrit Seferi
3. Z. Ergys Gezka
4. Znj. Fabiola Laço Egro
5. Z. Altin Hazizaj
6. Znj. Mirela Koçi

Përfaqësues nga **AMSHC**:

1. Znj. Eniana Koçiaj
2. Znj. Andia Ndreka

Pjesëmarrës të tjerë:

1. Znj. Eridana Çano – Drejtoreshë Ekzekutive – Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)
2. Znj. Ilda Koja – Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve
3. Z. Gentian Çeçe - Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

4. Z. Marjus Borokoçi – SASPAC
5. Znj. Juliana Hoxha – Partners Albania
6. Znj. Jetmira Hysenaj – Partners Albania
7. Znj. Aristeia Dibra – ANTTARC
8. Z. Elton Lelo – OSBE, konsulent
9. Znj. Natasha Mazari – EU TACSO
10. Z. Jonas Kepi – SAS-ALBANIA
11. Znj. Mirela Arqimandriti – GADC

Axhenda e takimit:

1. Fjala e hapjes dhe aprovimi i rendit të ditës – Znj. Denada Seferi.
2. Bashkëfinancimi publik për projektet e BE-së dhe formulari i përjashtimit nga TVSH për projektet e financuara nga BE - Znj.Eridana Çano.
3. Prezantim i ndryshimeve të parashikuara në Udhëzimin “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”- Znj. Enkeleda Kuçi, Znj. Ilda Koja, Z. Gentian Çeçe.
4. Diskutime dhe sugjerime për ndryshimet e propozuara nga anëtarët e KKSHC, përfaqësues të shoqërisë civile.

Drejton Mbledhjen Znj.Denada Seferi, Zv/Ministre - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Znj. Denada Seferi: Përshëndetje, duke kërkuar shumë ndjesë për vonesën, por janë periudha të ngarkuara dhe ka disa emergjenca. Ju kërkoj ndjesë për mungesën e Ministres, ndoshta na bashkohet pak më vonë, për momentin nuk është e mundur. Sot kemi të pranishme Znj. Eridana Çano dhe mund të vijojmë me axhendën. Do të flasim sot për disa çështje në lidhje me bashkëfinancimin publik për projektet e BE-së, dhe për formularin e përjashtimit nga tvsh për projektet me financim të huaj. Po ja jap pa humbur kohë fjalën Znj. Çano.

Znj. Eridana Çano – Shumë faleminderit Denada, shumë faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen, gëzohem sot që e kemi tavolinën plot. Kjo do të thotë që thirrja për këtë takim konsultativ ka gjetur interesin e duhur nga ana juaj. Unë e kërkoja posaçërisht pas takimit të fundit të Këshillit, që të ishim të gjithë në tavolinë, për të kuptuar veçoritë e problematikave dhe pengesave tuaja nga afër në përditshmëri dhe implementin e punës tuaj në lidhje me zbatimin e tvsh-së, dhe për të orientuar pak më qartazi punën që po bën Ministria e Financave në bashkëpunim me Agjencinë e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (SASPAC) për të sjellë ndryshimet në Udhëzimin e Ministrisë “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Unë nuk kam shumë për të thënë, por do t’ja jap më shumë fjalën Enkelejdës, e cila, së bashku me ish- Zv. Ministren Znj.Viero kanë qenë bashkudhëtarë në këtë proces të gjatë të konsultimit jo vetëm me përfituesit e drejtpërdrejtë siç jeni ju, por sidomos edhe me donatorët, si delegacioni i BE-së me të cilët besoj që të gjithëve ju ju lidh puna dhe projektet, por edhe me donatorë të tjerë të rëndësishëm. Në këtë mënyrë të kuptojmë edhe çfarë propozohet konkretisht në udhëzim, sepse jo gjithmonë ajo që shkruhet është e qartë, por edhe të kemi mundësinë t’ju dëgjojmë se çfarë mund të kemi humbur në këto parashikime nga shqetësimet konkrete tuajat. Pra ju kur shkoni tek kolegët e nderuar të Tatimeve të cilët i kemi sot prezent, të kuptojmë si mund ta ndihmojmë tani procesin para se ta finalizojmë atë, sepse nuk do donim që të na kthehen problematikat dhe presionet mbrapsh.

Do donim të dinim se çfarë nga propozimet dhe ndryshimet për këtë udhëzim janë relevante sipas jush dhe eksperiencës që ju keni në terren, problematika që ju keni hasur herë pas here me projektete, do t'ju bëjmë edhe ne sqarimet tona për çdo hap.

Ndërkohë përpara se t'ja jap fjalë Znj.Kuçi, unë si drejtuese e SASPAC, kam edhe një shqetësim të cilin do doja ta ngrija në këtë tryezë, për faktin që bëni shumë mirë që na kërkon llogari, por ka edhe një momet që ne duhet t'ju kërkojmë llogari juve që proceset të ecin mbarë – dhe këtë e kam edhe për ju Andi (AMSHC) që ndoshta duhet gjetur një instrument se si kjo çështje të përmirësohet pak. SASPAC është Agjensia e cila mbikqyr edhe programet ndërkufitare me shtetet e rajonit, pra nëpërmjet programeve IPA II që sapo u mbyll dhe IPA III që do fillojnë, kemi programin me Malin e Zi dhe Italinë, me Kosovën, Greqinë, Maqedoninë e Veriut. Problematika të shprehura ndër vite, është se krijohen konsorciumet, fitohen projektet merren edhe fondet e parafinancimit dhe organizata të ndryshme nuk përgjigjen, nuk raportojnë dhe nuk kthejnë më lekët – pra kemi këtë pengesën institucionale dhe të ndërveprimit në raste të tilla, ku partneri udhëheqës (lead partner) që mund të jetë shqitar apo nga vendet e rajonit, na kërkon ndihmë sepse nuk na kthehen mbrapsh detyrimet. E hodha si diskutim sepse jam e mendimit që të gjendet një mekanizëm pak shtrëngues, s'do të thoja detyrues, që edhe kur të vimë tek përfaqësimi dhe zbatimi i projekteve t'i shohim të dyja anët e medalies. Shumë faleminderit, Enkelejda fjala për ju.

Znj. Enkeleđa Kuçi – Shumë faleminderit, përshëndetje edhe nga ana ime. Sikurse tha edhe Znj.Çano, jemi këu sot për të bërë një përmbledhje të ndryshimeve të Udhëzimit “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”. Sikurse jeni në dijeni ka aktualisht në fuqi një Udhëzim për të cilin kemi patur çështje edhe shqetësime të ngritura nga ana juaj, dhe gjatë hartimit të këtij Udhëzimi jemi munduar të marrim prasysh edhe shqetësimet e ngritura prej jush.

Së pari, ndryshimet lidhen me detyrimin ose jo për t'u regjistruar për tatimin e shtuar. Aktualisht për të gjitha subjektet që i nënshtroheshin dispozitave të udhëzimit të tvsh lidhur me realizmin e projekteve të financuara me fonde donacion grant të marra në bazë të një marrëveshje midis Këshillit të Ministrave apo shtetit shqiptar dhe donatorit përkatës, ishte detyrimi që të gjithë duhet të regjistroheshin për qëllime të tatimit mbi vlerën e suar, përfshirë këtu edhe organizatat jofitimprurëse të cilat ka raste që në kuptim të dispozitave të ligjit nuk duhet të regjistrohen për tvsh. Pra një nga ndryshimet është pikërisht heqja e këtij detyrimi dhe detyrimi mbetet thjeshtë në zbatim të ligjit për tvsh. Pra nëse një organizatë është e detyruar me ligjin e tvsh të regjistrohet për tvsh, atëherë ajo duhet të regjistrohet, por jo posaçërisht për qëllime të këtyre projekteve.

Ndryshimet janë ideuar duke patur prasysh dy raste: rastin kur një projekt realizohet drejtpërdrejtë nga zbatuesi i projektit ose përfituesi nëse nuk ka zbatues, dhe në rastin kur projekti realizohet nëpërmjet një kontraktori, pra zbatuesi ka kontraktuar një person, entitet, apo shoqëri për të realizuar këtë projekt. Dhe kjo është ndarë në dy nënraste. Fillimisht bëhet regjistrimi i projektit në SASPAC, nuk ka pësuar ndryshime procedura këtu, paraqitet zbatuesi i projektit ose përfituesi në SASPAC, duke paraqitur dokumentacionin, marrëveshjen kuadër të lidhur mes shtetit shqiptar apo Këshillit të Ministrave dhe donatorit, ku në marrëveshje të jetë parashikuar që këto fonde nuk përdoren për të paguar tatime, kjo vjen nga kërkesat e Ligjit mbi vlerën e shtuar. Përveç kësaj marrëveshjeje duhet të paraqesin në SASPAC marrëveshjen apo një dokument të ngjashëm me këtë marrëveshje për këtë projekt, të shoqëruar me aktin miratues nëse ka një të tillë, si edhe një buxhet fillestar të projektit. SASPAC vlerëson dokumentacionin dhe brenda 10 ditësh lëshon çertifikatën e regjistrimit të projektit duke dhënë një kod unik për këtë projekt. Nëse nga ana e SASPAC konsiderohet e nevojshme plotësimi apo shtesa e ndonjë dokumentacioni tjetër, përsëri i kërkohet zbatuesit

të plotësojë dokumentacionin, me një afat 10 ditor. Pasi lëshon çertifikatën për regjistrimin e projektit, SASPAC ja dërgon menjëherë edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Doganave. Çertifikatat e lëshuara nga SASPAC, DPT i përcjell pastaj në Drejtorinë Rajonale përkatëse ku është regjistruar konkretisht zbatuesi i projektit. Me këtë çertifikatë Drejtoria Rajonale ku është regjistruar zbatuesi lëshon edhe formularin 7 A, çertifikatën për efekt të trajtimit të furnizimeve si furnizim të përngjashëm me eksportet. Këto janë dy dokumentet me të cilat zbatuesi i projektit do të paraqitet tek furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve me qëllim që t'i marrë ato pa tvsh. Duke disponuar këto dy dokumente ai paraqitet te furnizuesi i cili është i detyruar të faturojë këto mallra dhe shërbime pa tvsh. Ky është rasti i parë kur projektet realizohen nëpërmjet zbatuesit.

Ndërkohë kemi parashikuar edhe rastin kur zbatuesi i projektit e realizon me kontraktor. Këtu kemi parashikuar dy nënraste. Rasti i parë është kur kontraktori është një subjekt i cili nuk është i detyruar nga dispozitat e ligjit mbi tatimin mbi vlerën e shtuar, për të qenë i regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar – sikurse janë zakonisht organizatat jo-fitimprurëse. Në këtë rast çertifikata e projektit është ajo që merr zbatuesi, me këtë dokument kontraktori me çertifikatën e zbatuesit të projektit, së bashku me një kopje të kontratës që ka lidhur me zbatuesin, do të pajiset me çertifikatën nga drejtoria rajonale sipas formularit 7A ku në çertifikatë drejtoria rajonale do të evidentojë që subjekti nuk është i detyruar të regjistrohet për tatimin mbi vlerën e shtuar. Këto dokumenta janë të nevojshme që kontraktori të marrë tek furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve pa tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ndërkohë kontraktori do ja faturojë po pa tvsh zbatuesit të projektit. Ndërkohë në rastin kur projekti do të zbatohet nga një kontraktor, i cili detyrohet nga ligji i tvsh që të jetë i regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, ndryshimi është që kontraktori do i marrë mallrat dhe shërbimet nga furnizuesi i tyre sikurse i përcakton ligji, pra mund t'i ketë me tvsh standarte, me tvsh të reduktuar apo të përjashtuara, kontraktori për furnizimet që merr ka të drejtën e zbritjes dhe rimbussimit të tvsh ndërkohë që zbatuesit të projektit kontraktori do ja faturojë pa tvsh. Pra vetëm në këtë rast furnizimet pa tvsh do të fillojnë nga kontraktori tek zbatuesi i projektit. Kjo sa i përket skemës që ne kemi parashikuar në këtë udhëzim.

Gjithashtu është parashikuar që aplikimi për t'u pajisur me çertifikatë në Drejtorinë Rajonale përkatëse, të bëhet nëpërmjet portalit e-albania, por deri atëherë procedurat do vazhdojnë të bëhen manualisht. Pak a shumë këto janë ndryshimet kryesore që parashikohen në këtë udhëzim.

Është parashikuar gjithashtu që të gjitha rastet, pra duke qenë se thelbi lidhet me projektin konkret, trajtimi të jetë njësoj dhe të mos kemi dy dispozita, një për fondet e financuar nga BE dhe një për donatorët e tjerë siç ka qenë normalisht. Faleminderit!

Znj. Eridana Çano – edhe një gjë të fundit shtesë në lidhje me atë që tha Enkelejda për kalimin e këtij shërbimi tek e-albania ku edhe procedura do jetë shumë më e lehtë, sepse nuk do jetë më nevoja që të përgatitni dhe printoni një mori dokumentash, i sillni njëherë te SASPAC e pastaj ne ta kalojmë te drejtorinë e përgjithshme., dhe ajo që po bëjmë tani është të linjëzojmë të gjithë hallkat e këtij procesi, dhe pasi ne ta kemi miratuar dhe kolauduar, do shkojmë te kalimi i shërbimit nga hard-copy në “online”. Pra po bëjmë diçka paralelel që kur të kalojë i gjithë procesi online të jetë i mirë kolauduar dhe të mos ketë pengesa të tjera. Shumë faleminderit!

Znj. Enkelelda Kuçi – do doja të shtoja edhe diçka tjetër. Për sa i përket procedurës së përjashtimit në import, këtu nuk ka pësuar ndryshime, pra në import do të pajisen me autorizimin përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, qoftë zbatuesi i projektit qoftë nënkontraktori.

Znj. Denada Seferi – Shumë faleminderit, ndoshta do na duhet të dëgjojmë edhe kolegët e tjerë të pranishëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përpara se ta hapim diskutimin me të gjithë të pranishmit. Di që kemi prezent Ildën dhe Gentianin nga DPT të cilët mund të na sqarojnë pak më shumë disa detaje.

Z. Gentian Çeçe – Përshëndetje – pjesa e administratës tatimore për zbatimin në praktikë të përjashtimit dhe të verifikimit të kontratave, parimisht është më e thjeshtë se pjesa e parë. Çertifikata e SASPAC i përcillet DPT-së, e cila do të marrë masat respektive për ta përcjellë pranë drejtorive përkatëse rajonale ku subjekti është i regjistruar me një kohë sa më të shpejtë, më pas kontraktohet, ose në rastet kur projekti do të zbatohet me kontraktor së bashku me çertifikatën e SASAPC dhe kontratën e lidhur me subjektin respektiv që disponon kontratën e SASPAC, do të paraqiten pranë drejtorisë së tyre rajonale të tatimeve për të marrë formularin A4.

Përjashtimi i tvsh-së, furnizimi i ngjashëm me eksportet, do të zbatohet për cilindo subjekt që disponon një çertifikatë të vlefshme për vlerën e parashikuar shprehimisht në kontratë. Verifikimet pasuese do të jenë verifikime formale që të respektohet kontrata dhe marrëveshja respektive e lidhur me palët. Synohet që projekti të ketë një vijueshmëri të pranueshme dhe pa problematika të tjera në praktikë, dhe normalisht pastaj përpjekja dhe disponimi për të zgjidhur çdo problematikë që do të dalë rrugës, do të jetë gjithmonë maksimale. Me atë që udhëzimi ka parashikuar, dhe “workflow” që zonjat e nderuara përmendën paraprakisht, janë marrë masa që kjo procedurë të ecë e të mos ketë problematika. Në varësi të nevojave konkrete, do të shqyrtohet pastaj çdo gjë rast pas rasti.

Znj. Denada Seferi – faleminderit, po hapim diskutimet.

Z. Altin Hazizaj – përpara se të hapet diskutimi në detaje, kam vetëm një pyetje – Sa subjekte dhe sa OJF që janë subjekte të tvsh-së apo të këtij udhëzimi kanë aplikuar?

Z. Gentian Çeçe – nuk mund të them një shifër konkrete këtu. Praktikisht për shkak të udhëzimit që po ndryshohet, aplikimet e subjekteve për t’u regjistruar për tatimin mbi vlerën e shuar, dhe që më pas kanë kërkuar edhe përjashtimin, numri ka qenë i vogël, i kufizuar. Kërkesa për aplikim për rimbursim para kësaj procedure nuk kanë qenë në një masë të konsiderueshme, le të themi kanë qenë kërkesa që nuk kalojnë shifrat dy-shifrore. Kjo ka ardhur edhe për shkak se OJF-t, të cilat duken si më të penalizuara në këtë drejtim, kanë menduar se mbase nuk ja vlen të regjistrohen fare për tvsh për t’i hyrë kësaj procedure rimbursimi nëpërmjet DPT. Kjo ka bërë që edhe pastaj në gjykim të vlerësohen si furnizime të ngjashme me eksportet pjesa që duhet të përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Znj. Mirela Arqimandriti – Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim. Kam tre raste që do doja t’i sillja për të kuptuar si do të menaxhohen. Në rastet kur është një projekt rajonal ku lideri i projektit është në Shqipëri, por nuk do të menaxhojë gjithë fondin vetë por do të ndajë fondet në rajon, në Maqedoni, Kosovë etj., në këtë rast kur të aplikojë si do zgjidhet kjo gjë?

E dyta kur lideri është në Maqedoni dhe përfituesi në Shqipëri, pra kontratën nuk e ka direkt me donatorin që mund të jetë për shembull austriak, por e ka me partnerin kryesor që është në Maqedoni, dhe që nuk e di nëse kjo marrëveshja e bashkëpunimit kuadër është lidhur apo jo – pra si do funksionojë në këtë rast.

Dhe rasti i tretë është për shembull kur merr një projekt të BE-së dhe ke dy partnerë shqiptarë, përsëri këtu do aplikojë lideri dhe të tjerët automatikisht do përfitojnë, apo duhet të aplikojë secili më vete? Këto tre raste kisha.

Znj. Enkeleda Kuçi – Së pari duhet të ndajmë disa gjëra. Draft udhëzimi që po paraqesim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit mbi tatimin mbi vlerën e shuar, ku konkretisht në nenin 60, të Ligjit 92/2014 nga janari i vitit 2023 është parashikuar që mallrat dhe shërbimet e destinuar për realizimin e projekteve të financuara me fonde donacion grant mbi bazën e një marrëveshjeje të lidhur midis shtetit shqiptar, Këshillit të Ministrave dhe donatorit, trajtohen si furnizime të përngjashme me eksportet. Pra kushitn për të pasur një marrëveshje midis shtetit shqiptar dhe donatorit apo Këshillit të Ministrave dhe Donatorit, është një kushtëzim që na rrjedh nga Ligji në fjalë.

Znj. Eridana Çano - T'i shkojmë rast pas rasti. Në rastin e projektit rajonal ku lideri është në Shqipëri, në këtë draft udhëzim që po prezantojmë momentalisht, nuk e kemi prekur tërësisht pjesën e projekteve rajonale globale sepse jo të gjithë këto projekte, për të mos thënë asnjë prej tyre, nuk ka një marrëveshje standarte siç e kanë donatorët apo projektet apo programet e tjera. Kjo është një çështje, të cilën ndoshta duhet ta kishim prezantuar në fillim të takimit, pasi të mbyllim takimin e sotshëm me ju, do ta diskutojmë me Ministrinë e Jashtme, me Ministrinë e Financave në tavolinë, me shpresën që këto lloj proketesh të rimbursohen nga Ministria e Punëve të Jashtme. Po flasim këtu për programet, projektet, agjensitë të cilat kanë programme me marrëveshje apo me bazë ligjore të njohur, të ratifikuar, ku përjashtimi, sepse rimbursimi nuk është më i mundshëm, pra përjashtimi bëhet që në momentin e parë. Për këtë rast pra do t'ju japim një përgjigje përfundimtare pasi ta shqyrtojmë edhe me Ministrinë e Jashtme për vijimësi. Për dy rastet e tjera që parashtrroi Znj.Arqimandriti, po ja lë fjalën Enkelejdës.

Nëse është rasti për projektet rajonale, ne kemi bërë më përpara një ushtrim me GIZ-in, i cili ka një seri të madhe projektesh rajonale dhe globale, dhe përgjigja që na është dhënë nga Ministria e Financave, është se këto nuk mund të trajtohen njësoj si projekte sepse nuk ka bazë ligjore. Ligji nuk e njeh këtë pjesë për sa kohë nuk ka një marrëveshje, për sa kohë s'kemi bazë ligjore ku mund të mbështetemi, kështu që do ta flasim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke u munduar që t'i japim drejtim.

Znj. Mirela Arqimandriti - Marrëveshjet kuadro lidhur mes Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve, ku gjenden? Tek faqja e Ministrisë së Jashtme?

Z. Andi Kananaj – te QBZ

Znj. Eridana Çano - Ka disa që i bën Ministria e Jashtme, ato të Huasë i ka Ministria e Financave, disa të tjera i kemi ne si SASPAC, kështu që po tek QBZ.

Z. Altin Hazizaj – e para, edhe si anëtar i KKSHC pa diskutim dua të shpreh përgëzimet e mia për punën e madhe të bërë, por kam një ndjesi, që me gjithë dëshirën e mirë që ekziston, me këtë draft udhëzim e keni komplikuar jetën më shumë se ç'duhet. Kjo është thjesht përshtypja ime, dhe e them si person që vi nga juridiku, si avokat. Kuptoj edhe një gjë tjetër, që aftësimi juridik sidomos te financat është i tillë, që në vend që t'i thjeshtëzojnë proceset i kompikojnë ato. Dhe unë këtu kam disa çështje që mendoj se duhen diskutuar. Draftin aktual edhe njëhëre dua ta theksoj, e përsërites, mund të ketë gjëra të vogla të cilat mund të rregullohen patjetër, por ky draft nuk e zgjidh problemin e madh të tvsh-së për shoqërinë civile.

A jeni ju të ndërgjegjësuar mjaftueshëm, që përpos kësaj që duhet të jetë një masë e ndërmjetme, të paktën unë e shoh si të tillë, të fillojmë të mendojmë seriozisht për ndryshimin e ligjit? Kjo sigurisht nuk është kompetencë vetëm e juaja, ëshë e drejta jonë ta kërkojmë, ministrië janë këtu, ne kemi të drejtë ta ngremë në këtë Këshill. Ajo që unë shikoj si zgjidhje është shumë e thjeshtë: Ligji thotë që OJF-të nuk janë subjekt i tvsh-së. Për aq kohë sa ka një parim bazë, që është si parim kushtetues, pra për aq kohë sa ojf-të nuk kanë një aktivitet ekonomik etj etj, 99% e organizatave, dhe jo më kot kërkoja edhe numrin e organizatave më parë. Pra ju keni të drejtë të vini me të dhëna të sakta, dhe të na thoni që buxhetit të shtetit i bëhet për shembull një dëm x ekonomik, dhe këtu do të na duhet sigurisht të negociojmë. Në momentin që ne trajtohemi të gjithë sikur jemi fitmpriurës, por ndërkohë në letër nuk jemi të tillë, edhe në sistemin që ju zbatoni, atëherë automatikisht këtu ka një mangësi të theksuar të zbatimit të ligjit si duhet.

Mënyra si e shoh unë, i përjashtuar nga tvsh do të thotë që NIPT-i që organizata x ka për efekte jo-ekonomike, pra unë nuk kam aplikuar për të hapur biznes, biznes social apo jo, nuk ka rëndësi, atëherë ky NIPT automatikisht duhet të jetë i përjashtuar nga tvsh-ja që në fillim. Dhe kjo duhet bërë! Nëse pastaj organizata kërkon të ushtrojë aktivitet ekonomik, atëherë mund të hapet NIPT-i sekondar etj, - A jemi duke vajtur drejt kësaj apo jo? Sepse kjo është pyetja dhe çështja kryesore për mua. Pra me këtë akt keni zgjidhur një hap të vogël të ndërmjetëm, por i cili mbetet shumë i komplikuar për mua sepse do t'ju sjellë komplikacione në të ardhmen edhe për ju por besoj edhe për shoqërinë civile.

Një tjetër problem i madh është edhe financimi i projekteve të BE-së, e cila (BE-ja) do të kthehet në donatorin kryesor për shoqërinë civile edhe në nivel rajonal, shtetëror, edhe të BE-së – është çështja e bashkëfinancimit nga fondet publike, sepse është vendosur në Axhendë por nuk u diskutua as kjo gjë. Për t'u mbyllur të paktën tvsh-në dhe bashkëfinancimin mund ta bëjmë në një mbledhje tjetër. Është shumë e rëndësishme të krijojmë një koncept bazë, pra çfarë sistemi duam, o do bëjmë një sistem që përfundimisht e thjeshtëzojnë çështjen pra mora unë sot statusin si ojf, dhe automatikisht marr statusin e përjashtuar, pra kjo duhet të jetë forma - dhe automatikisht në momentin që kryen aktivitet ekonomik atëherë automatikisht me ligj apo edhe si vepër penale, nëse s'e ke regjistruar për të tillë, të penalizohesh. Pra zgjidhje ligjore ka, zgjidhjet ekonomike nëqoftëse doni t'i ktheni në zgjidhje ligjore, gjithmonë bëjnë sens – këtë po mundohem të them.

Znj. Enkeleda Kuçi – dua të bëj thjesht një sqarim. Synimi i draftit ka qenë për ta bërë sa më të qartë e të thjeshtë, të paktën deri tani në vlerësimin tonë ne kemi bërë thjesht një ndarje për të pasur qartësi dhe thjeshtësim. Të rregullonim dhe adresonim çështjet e ngritura, dhe ishte parashtruar si çështje detyrimi për regjistrim, dhe këtë për shembull e hoqëm. Dhe ndarja është bërë për thjeshtësim, dhe nga ana procedurale nuk mendoj që është shtuar as edhe një procedurë. Ku mendoni që konkretisht ka vëshirësim? Që ta marrim konkretisht meqë jemi këtu, dhe ta adresojmë në kohë.

Znj. Eridana Çano – është shumë mirë që këtu po sillen qasje që ne më përpara s'i kemi dëgjuar, ose s'i kemi hasur, dhe për t'i dhënë edhe përgjigjen Altinit, nëse ne shohim - unë në cilësinë si drejtuese e SASPAC por edhe me mirëkuptimin e kolegëve, - pra nëse ne e shohim që ky ligj që ju po propozoni ka nevojë për ndryshime, por duke marrë evidenca të qenësishme nga ana jua për nevojën e këtyre ndryshimeve, dhe duke mbajtur parasysh direktivat, atëherë në një moment të dytë ne do ta marrim patjetër përsipër këtë ndryshim. Por kjo në një moment të dytë, tani që po flasim është udhëzimi që mos ta mbajmë edhe më shumë udhëzimin sepse proceset duhet të ecin përpara. Më është propozuar në axhendë për të folur për këtë pikë, por sot do donim që të mbyllim njëherë pjesën e Udhëzimit dhe të jemi të gatshëm për të gjitha të tjerat.

Znj. Enkeleda Kuçi – duhet të ndajmë edhe një gjë tjetër, që udhëzimi nuk është i dedikuar vetëm për organizatat jo-fitmprurëse, sese është Udhëzim që buron nga Ligji. Dhe ligji nuk e ndan që në këtë rast po flaism vetëm për organizata jofitmprurëse.

Z. Altin Hazizaj - Dhe unë në vetvete këtë gjë po propozoj – ndryshime që burojnë nga një ligj që ka probleme automatikisht do jenë difektoze edhe vetë.

Znj. Eridana Çano – ne mund të bëjmë edhe një takim për të marrë propozime mbledhje mendimesh të veçantë vetëm për pengesat dhe problemet që ka ligji i tvsh-së për të pasur një propozim konkret te Ministria e Financave.

Znj. Enkeleda Kuçi - Ligji i tvsh dhe ai që është aktualisht ka synuar dhe është në përputhje të pjesshme me direktivën e BE-së që rregullon tatimin mbi vlerën e shtuar në BE, se ndryshe nga tatimi mbi të ardhurat, tvsh-ja është një tatim i harmonizuar me direktivat. Pra kemi një direktivë, të cilën në kuadër të procesit të integritimit jemi të detyruar ta përshtasim tërësisht me ato të BE, ky ligj është pothuaj i përputhur me këtë direktivë. Pra edhe këtë pjesë duhet ta mbajmë në konsideratë kur e diskutojmë, sepse kemi disa dispozita që janë detyruese si pasojë e direktivës.

Znj. Mirela Koçi - Përshëndetje, unë jam Mirela Koçi nga Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal në Vlorë. Në fakt, si procedurë unë e shikoj Udhëzimin pak a shumë të ngjashëm, duke përjashtuar çertifikatën që ne tashmë e marrim nga SASPAK-u, dhe unë e kam marrë një të tillë nga SASPAK-u për përjashtim, por ka qënë pak a shumë si Udhëzimi i 2008, me të njëjtat dokumenta dhe procedura, që fatkeqsisht nuk ka funksionuar. Unë jam një ndër organizatat që kam bërë vazhdimisht kërkesa për rimbursim TVSH-je, madje i kam dhënë informacionin Drejtorisë Rajonale të Tatim Taksave në Vlorë, sepse as nuk e kishte idenë e Udhëzimit të 2008, dhe kjo duhet të jetë një nga pikat pastaj sensitive që ne e njohim legjislacionin në Drejtorinë e Përgjithshme, e njohim dhe në Drejtorinë Rajonale të Tiranës por kur dalim jashtë në rrethe të tjera nuk njohim asgjë dhe nuk kemi informacion. Ne kemi shumë punë që të bindim Drejtoritë Rajonale se ku e kemi problemin, se si duhet bërë procedura sepse informacioni nuk zbret nga vertikalia në rrethe. Ne këtë e kemi vuajtur praktikisht, për të mos thënë pastaj që humbasin në kohë, sepse atëherë ishte që të aplikonim direkt në momentin që fillon projekti, ndërkohë ti merrje një shkresë që nuk je subjekt i regjistruar për rimbursim TVSH-je dhe automatikisht gjithë faturat që kishim prerë nuk të rimburoheshin, dhe po flisni me dikë që e ka me 3-shifra vlerën e akumuluar të TVSH-së në disa vite.

Kemi marrë çertifikatën nga SASPAC, që për hir të së vërtetës ishte një procedurë e kolauduar, jo për një projekt por për katër të tilla, kështu që në një farë mënyre kemi ngelur këtu, pra që do të thotë që çertifikatën e parë unë e kam marrë në muajin maj, të një projekti EuroMed, me marrëveshje kuadër me gjithçka tjetër dhe ajo që po pres, edhe në takimet e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, është pikërisht se kush është procedura praktike që mua më duhet të ndjek. Draft-Udhëzimin e shoh shumë mirë, dhe nuk e di në është dërguar drejtorive dhe janë në dijeni, kjo ishte pyetja ime e parë.

Znj. Enkeleda Kuçi- Nuk është miratuar. Akoma jemi në draft.

Znj. Mirela Koçi - Nuk është miratuar akoma, që do të thotë që kur të miratohet unë mund të shkoj tek Drejtoria Rajonale dhe të kërkoj të marr formularin A7? Dhe me këtë unë kryej të gjithë procedurat e tjera. Kështu është në rregull? Ok.

Ndërkohë ne kemi të nënkontraktuar, se jo i gjithë projekti implementohet nga ne, pra kemi të nënkontraktuar sipas një plani prokurimi që e kemi dorëzuar që një kontraktim mund të bëhet ditën e parë, një në ditën e dytë dhe një mund të bëhet dhe në fund të projektit. Kur bëme diskutimin e parë ju thatë që, ne duhet të dorëzojmë në Drejtorinë e Tatim-Taksave listën me emrat e subjekteve që kemi kontraktuar, tani ka ndryshuar apo jo?

Znj. Enkeleda Kuçi- Normalisht lista është tek Udhëzimi aktual, për këtë flasim apo jo?

Znj.Mirela Koçi- Jo unë si organizatë kam shërbime që nuk i bëj vetë, i kam ose externum, i kam ose infrastrukturë kur kam një projekt për infrastrukturë dhe automatikisht do të nënkontraktoj.

Znj. Enkeleda Kuçi- Pra donatori ju ka caktuar si zbatues të projektit?

Znj.Mirela Koçi- Po unë jam zbatuesi i projektit.

Znj. Enkeleda Kuçi- Nëse ju jeni zbatuesi i projektit, pra jemi në rastin e parë që projektin do ta realizoni vetë dhe me çertifikatën nga SASPAK dhe me çertifikatën nga Drejtoria Rajonale do i merrni mallrat apo shërbimet në funksion të këtij projekti nga furnitori i tyre do i merrni pa TVSH. Në rast se një pjesë nuk e bëni vetë por ju kontraktoni një person tjetër, në varësi të faktit kontraktori është përsëri një OJF, do vejë vetë kontraktori në Drejtorinë Rajonale ku ai është i regjistruar me çertifikatën e projektit tuaj, së bashku me kontratën tuaj.

Znj.Mirela Koçi- Pra unë këtu e shoh dobësinë, unë mendoj se cili nga bizneset do ta bëjë këtë gjë.

Znj. Enkeleda Kuçi- Varet kë quani ju kontraktor?

Znj.Mirela Koçi- Unë mund të kemi kontraktor një biznes, një zyrë që më ofron shërbim, që është subjekt me TVSH që për shembull do më bëjë dizenjimin mua.

Znj. Enkeleda Kuçi- Po pra, vetëm ai do vejë të marrë në Drejtorinë Rajonale, sepse projektit tuaj ai do t'i faturojë pa TVSH, ndërkohë nëqoftëse ai është OJF do e marrë dhe ai pa TVSH, nëqoftëse është person i regjistruar me TVSH do e marrë me TVSH.

Znj.Mirela Koçi - Nuk e di se sa subjekti do të jetë i interesuar që ta bëjë këtë gjë, subjekti thotë që unë jam me TVSH, do ta pres faturën me TVSH.

Znj. Enkeleda Kuçi - Po ai nuk është kontraktori juaj atëhere. Këtu flasim për furnitorin, ai është furnitori nëse thua këtë. Kontraktori është ai me të cilin ju lidhni një kontratë.

Znj.Mirela Koçi- Në terminologjinë e prokurimeve ne e quajmë të kontraktuar, në terminologjinë e financës ne e quajmë furnitor. Ndoshta dhe këtu ka nevojë që te Udhëzimi të ketë një shpjegim të qartë të termave, që dhe ne ta kemi të qartë këtë pjesë. Sepse nuk na përputhen me ato që ne punojmë.

Znj. Eridana Çano- Ne prandaj po i bëjmë dhe këto takime konsultative. Takimet që kemi bërë që nuk janë një, dy apo pesë po janë më shumë se njëzet takime deri tani me të gjithë donatorët duke filluar nga EU duke mbaruar deri te pika më fundore, na dilnin aq shumë skenare, pra vinin me aq shumë pyetje sa që pyesnim

veten ndonjëherë që a e kemi bërë Udhëzimin mirë, por në fakt janë të gjitha grupazhe të këtyre dy skenareve, por për shkak të terminologjisë duket sikur janë shumë, por në fakt është kështu. Pra, është çertifikata juaj e cila që në moment kur ai ua jep shërbimin duhet ta japë me zero TVSH.

Znj. Enkeleda Kuçi – Ndjesë. *Furnitor* është një person, një shitës mallrash apo shërbimesh i cili i furnizon kujtdo, pra nuk është se ka një kontratë me personin marrës të malli apo të shërbimit, për qëllime të tatimit, ai është furnitor. Kurse *kontraktori* është ai që ka një marrëdhënie kontraktuale midis jush dhe atij.

Znj. Eridana Çano- Mund t’ju them dhe diçka tjetër ju lutem, sa për t’i ardhur në ndihmë zonjës. Atëherë ne si SASPAK kemi marrë angazhime dhe nuk çertifikojmë ne sepse çertifikimin e bëjnë zotërinjtë përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim-Taksave). Marjusi është drejtor i zyrës që merret me çertifikimin tek SASPAC, ne do të ngremë një mini ekip, e kemi ekipin por do t’jua bëjmë ju me dije se çfarëdo lloj problematike që ju hasni me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim-Taksave apo dhe me Drejtorinë Rajonale na bëni me dije dhe ne të jemi pastaj facilitatorët e procesit. Pra, të keni një moment që jo të ankoheni, por të ndihmoheni. Ky është momenti pa pasur një mekanizëm tjetër, i cili do të quhet në fakt, faqja zyrtare e SASPAC-ut të cilin ne po e ndërtojmë, dhe aty pastaj do të keni të gjitha informacionet edhe për çertifikimin edhe për e-mail adresën apo dhe personin që do të kontaktoni kur do të keni një problematikë.

Znj. Juliana Hoxha – Faleminderit të gjitha palëve për këtë mundësi dhe për këtë hapsirë, faleminderit sepse në fakt ka qenë një betejë e gjatë. Me znj. Enkeleda Kuçi kemi bërë një debat në Ministrinë e Financave në fillim të këtij viti, ne e kemi ndjekur me të gjitha institucionet dhe me thënë të drejtën më vjen mirë që pjesa e TVSH-së ka rënë sepse ka qenë një nga rekomandimet tona, detyrimi për regjistrim.

Dua të shtroj disa momente që ne gjykojmë që kanë nevojë për t’u sqaruar, për Udhëzimin në fjalë. E mora përgjigjen, kam përshtypjen që e tha znj. Denada, por për ta konfirmuar sipas ndryshimit në Udhëzimin në fjalë, *neni 63/1* që ka rënë pjesa e fondeve apo projekteve të BE-së nënkupton që janë unifikuar të dyja, kështu e kuptuam dhe ne dhe qenka në rregull.

Përsa i përket pjesës, do të thoja gjithë frymës së Udhëzimit, them që ka një keqkuptim se kush shërben dhe ka probleme me termat dhe kjo do të thoja unë do ishte shumë e udhës duke pasur parasysh dhe kompleksitetin e procesit, të paktën *termat duhet të ishin më pranë botës tonë*, sepse ka konfuzion për këtë gjë dhe do të thoja që Udhëzimi për rimbursimin e TVSH-së, mbetet një model i mirë përse i përket termave në eksperiencën tonë. Ne jemi nga ato organizata që kemi marrë katër rimbursime të TVSH-së deri në fillim të këtij viti. Proçesi është i thjeshtë për ne, ka gjëra që duheshin sqaruar në sistem, sepse me shumë të drejtë do të thoja Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Taksave në mënyrën sesi do të çertifikohen shpenzimet, kishte pyetje që dilnin gjatë procesit, por kjo është tjetër histori. Po e sjell Udhëzimin vetëm për hatër të terminologjisë, pasi terminologjia e përdorur këtu nuk është e jona.

Konfuzioni i parë, unë e vlerësoj shumë punën e bërë, sepse kemi pasur debate që ky nuk ekziston si problem, por besoj që pas dy vitesh që bëhen në mars, dhe përderisa jemi këtu akoma tregon që nuk ka funksionuar, dhe në fakt Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Taksave kanë bërë një skenar që kush është kontraktori, kush është donatori dhe ju thashë atyre që me gjithë këtë punë që keni bërë mua më duhet një shkollë për ta kuptuar këtë skemën. Ky draft e ka thjeshtuar pak patjetër, por *ka nevojë për qartësim termash*, është në hyrje të Udhëzimit por mbetet prap e paqartë. *Mënyra sesi e trajton Udhëzimi*, të paktën për aspektin e NGO-ve, *duket sikur zbatuesi apo përfutuesi i projektit është në pjesën më të madhe një agjenci e madhe donatorësh, por në fakt nuk jemi ne dhe nuk është e vërtetë, se fondet e BE-së administrohen me ndërmjetës,*

pra me organizata ndërmjetëse, ne kemi shumë programe të BE-së që ne veprojmë le të themi “për llogari të” dhe japim grante. Pse e sjell këtë gjë, se është në shpirt të Udhëzimit, kjo për shembull ka, kërkesa e parë që mua nuk më duket normale është, që kërkon marrëveshjen bilaterale të shtetit respektiv me qeverinë shqiptare. Unë kam punuar në Minsitrinë e Financave për Udhëzimin e Rimbursimit dhe një ndër çështjet ka qenë kjo dhe pastaj u ra dakort dhe e hoqëm, mund të gjendet në fletoren zyrtare patjetër por marrëveshja bilaterale mes shteteve përderisa është një dokument shtetëror që shkarkohet nuk mund t’i kërkohej çdo NGO-je që shko te SASPAC që të çojë këtë, duket si gjë e vogël por nuk është e tillë. Duhet të futesh në të gjitha këto kanale që ta marrësh këtë gjë.

Znj. Eridana Çano- e marr unë që tani përsipër që do të hiqët kjo gjë. Përderisa ne e kemi nuk kemi pse ua kërkojmë OJF-ve. E para e punës si tek bashkëqeverisja kemi bërë një inxhinierim të të gjitha proceseve që janë shërbime publike dhe bizneseve. Duke qenë se e kemi shërbim këtë, dhe për arsye thjeshtimi, duhet që të mos kërkojmë në këtë rast OJQ-ve çështje dokumentash që vetë shteti i ka dhe që të na i sillni ju nga një kopje. Nëse është kështu në draftin final e keni të sigurt që është e hequr. Është pika i neni 63/1.

Znj. Juliana Hoxha- Kjo nuk është çështje përtese por dorëzimi i marrëveshjes nga ana ime nuk do të thotë asnjë gjë për dhënien e grantit.

Znj. Eridana Çano- E hoqëm pra. Do të bëjmë një vetëdeklarim që jam pjesë e këtij projekti në bazë të marrëveshjes X. Shteti shqiptar me Kryeministër z. Edi Rama e ka bërë këtë gjë për të gjitha shërbimet që në krye të herës, që në 2020 dhe sot jemi 4 vite mbrapa dhe nuk mund të ngelemi mbrapa.

Znj. Juliana Hoxha- Nëse kjo gjë, kjo nuk është një çështje për ta diskutuar sepse nuk është për ne, por neqoftëse për 1001 arsye, SASPAC, apo Tatim-Taksave i duhet ky informacion, unë nuk jam si NGO, organi për ta ofruar këtë, sepse unë firmos një marrëveshje granti dhe nuk e di fare se nga vjen, fakti që unë e deklaroj nuk përbën provë për ju. Ajo provë duhet të jetë një kërkesë, po bëjani donatorëve që kontratat e grantit të bëjnë referencë të marrëveshjes apo si alokohen këto fonde në Shqipëri. Domethënë është një informacion i tepërt që nuk kam pse ta kem unë për një gjë që ndodh midis dy qeverive. Nëse jeni në diskutime me donatorët kjo është një gjë shumë e thjeshtë që të referohet/përfshihet në kontratat e grantit t’i bëhet referencë marrëveshjes. Se unë mund t’ia fus dhe kot padashje, jo me qëllim por mund t’ia fus dhe kot.

Për të dalë pak te një gjë që e gjykoj të rëndësishme, me marrjen e certifikatës i bëhet referencë donatorit, tani pjesa më e madhe gati 90% e granteve, BE-ja është 100%, po pjesa më e madhe e granteve që ne marrim pra projekteve që në zbatojmë janë me “code share” nuk janë 100%, pyetja që kisha pasi është e qartë por ngre shumë pikëpyetje. Kur unë vij dhe regjistrohem në SASPAC, tani kam një projekt që ka dy donatorë, financohet nga dy burime, unë duhet të marr dy certifikata? Si lëshohet certifikata ime?

Znj. Enkeleda Kuçi - Është një kod unik pavarësisht sa është numri i donatorëve. Domethënë kodi është projekti jo donatori.

Znj. Juliana Hoxha – E qartë, në momentin kur të dy donatorët janë subjekt i ligjit, i përjashtimit. Tani nëse unë kam BE dhe një që është jashtë optikës së ligjit e po them një fondacion privat i huaj, ne punojmë me fondacione amerikane, ne punojmë me Rockefeller Brothers Fund nuk është subjekt i këtij ligji dhe unë kam një projekt që financohet nga BE-ja dhe RBF-ja, tani ideja është që si pjesë e asaj që unë regjistroj është vetëm pjesa e donatorëve, ose në rastin më klasik, kur ne lidhim kontratat e grantit BE-ja thotë vlera e aksionit pra 100% le të themi që është 100 euro, 5 euro është buxheti im 5 % është detyrimi jot. Dhe ky 5% që është

detyrimi im si “code share” unë mund ta vë nga lekët e mia nëse kam mundësi ose do të tërheq një donator tjetër. Tani pyetja e parë është kur certifikohet pra merret certifikata merret për 95% apo për 100%?

Znj. Enkeleda Kuçi- Merret vetëm për 95%.

Znj. Juliana Hoxha- Qartë, dhe në momentin kur unë fus në projekt te kjo 5% një donator tjetër, fakti që certifikata merret për projektin si e certifikoj unë këtë donatorin tjetër që është prap subjekt i ligjit? Pra, 95% është BE-ja dhe në një moment të dytë unë tërheq këtë 5% dhe është donator pjesë e subjektit të ligjit që mund të jetë pas 1 viti?

Znj. Enkeleda Kuçi- Në këtë rast përditësohet certifikata në SASPAC.

Znj. Juliana Hoxha- Pra ideja është që duhet ta bëj dhe një herë ciklin sepse do të çohen dokumentat në SASPAC dhe nga aty te Tatim-Taksat sepse është vlerë e rritur dhe është shtuar një donator tjetër pjesë e subjektit të ligjit, Në një fare forme, si një aplikim i ri por me të njëjtin numër dhe me të njëjtin projekt. Kjo ishte për sqarimin tonë sepse për ne është e rëndësishme sepse ne sqarojmë dhe sektorin.

Znj. Eridana Çano- Në momentin që këtë shërbim do ta kalojmë online, dhe rifreskimi i kartelave të pasurisë dhe rifreskimi i certifikatës së SASPAC që do të bëhet po prapë online do t’i ketë këto hapat më të shkurtuara dhe kjo gjë kalon nga SASPAC menjëherë në Drejtorinë e Tatim Taksave.

Znj. Juliana Hoxha- Meqënëse e kapa Znj. Eridana në një moment të mirë, tek *neni 63/1 pika ii* thjeshtë se administratat ndërrojnë dhe nuk dua që të ketë keqinterpretime apo gjëra që bëhen pak problematike. *Pika i* thotë shoqëruar me akt miratimin, nuk është procedurë e donatorëve kjo gjëja. Pra, donatorët nuk kanë letër miratuese, kontrata është e vetmja gjë që ne marrim. Fakti që nuk ndodh, që në 100% të rasteve nuk marrim letër.

Znj. Enkeleda Kuçi- Na është ngritur si çështje se ka pasur dhe me donatorët, që thoshin që të lëshonin nëndorësh një letër apo dokument të ngjashëm, por do ta rishikojmë si formulim duke e vënë marrëveshjen e posaçme apo një dokument të ngjashëm që rregullon projektin, e shoqëruar me aktin miratues nëse ka një të tillë, nëse s’ka atëherë s’është e nevojshme. Por do të rishikohet si formulim sepse për shkak se jemi në fazë konsultimesh nuk janë reflektuar të gjitha komentet që ne kemi marrë.

Znj. Juliana Hoxha- tek i njëjti nen, Neni 63 pika c, kam përshtypjen se është lapsus por më shumë për ta sqaruar, tek fjalia e dytë thuhet: të dhënat e zbatuesit dhe përfituesit – besoj lidhëza “dhe” është lapsus, duhet të jetë “ose” përfituesit?

Znj. Enkeleda Kuçi - Po është lapsus

Znj. Juliana Hoxha – si e marrim ne vesh, kur nuk është online, si e marrim certifikatën?

Znj. Enkeleda Kuçi – do të dërgohet nëpërmjet email-it, ose më saktë nëpërmjet faqes së tatimeve tek rubrika “Çështjet e Mia”, ose nëpërmjet shërbimit postar rekomande – sikurse dërgon administrata çdo njoftim ndaj tatim-paguesve. Edhe këtë e kemi përfshirë si rekomandim.

Znj. Eridana Çano – këtë pjesë do e ndjek unë.

Znj. Juliana Hoxha – diçka shumë e vogël, tek pikaf F thuhet monedha – kush është ideja e përdorimit të monedhës sepse të gjitha raportimet bëhen në lekë, pra ka qëllim specific?

Znj. Enkelelda Kuçi - Jo është për të qenë gjithëpërfshirëse.

Znj. Juliana Hoxha – mbaron neni 3, është pika i, që lidhet me zbatuesin / përfituesin nëqoftëse ti je zbatues.

Znj. Enkelelda Kuçi – *Përfituesi është gjithmonë nëse nuk ka zbatues*, dhe sa për sqarim shtesë - duke qenë se aktualisht kemi në fuqi një udhëzim, jemi përpjekur të adresojmë problematikat, çështjet por jo të bëjmë ndryshime shumë të mëdha që do na përplaseshin – prandaj kemi ruajtur edhe pjesën e terminologjisë.

Znj. Juliana Hoxha – duket sikur zbatuesi, ose përfituesi kur nuk ka zbatues, duhet të paraqesë dy certifikata, dhe nëse jam kontraktor paraqes vetëm 1 - A do jetë kjo procedurë? Se duket sikur detyrimi më i lartë është për rrënjën, pra unë e marr nga zbatuesi ose përfituesi.

Znj. Enkelelda Kuçi – *zbatuesi ka certifikatën e SASPAC dhe certifikatën e Drejtorisë Rajonale. Me këto të dyja vete dhe paraqitet. Ndërkohë kur ka një kontraktor në mes, atëherë është certifikata e SASPAC, por edhe certifikata që pajiset kontraktori.*

Znj. Juliana Hoxha - pra kur shkon bën blerjen kontraktori paraqet vetëm certifikatën e vet tatimore dhe jo certifikatën bashkëshoqëruesi të e SASPAC-ut të zbatuesit.

Znj. Enkelelda Kuçi – nuk është e nevojshme në këtë rast, sepse ajo i ka shërbyer tatimeve për të lëshuar këtë certifikatë.

Znj. Eridana Çano - Dhe kodi i identifikimit unik të projektit është tek certifikata tatimore.

Znj. Juliana Hoxha – flitet në udhëzim për formate të reja – por ne nuk shohim formate të reja

Znj. Enkelelda Kuçi - Në udhëzim flitet për formularin e tatimeve, certifikatën 7 A, dhe është parashikuar një rubrikë që do bëjë evidentimin e faktit nëse është subjekt i tvsh apo jo.

Znj. Juliana Hoxha - Certifikata që kemi marrë nuk është e re, a është ende në fuqi e vjetra apo ka diçka tjetër? Sepse ekzistuesja nuk ka informacionin që kërkon udhëzimi, dhe kjo është problematike.

Znj. Eridana Çano – do të përshtaten dhe rishikohen të gjitha, të dyja certifikatat edhe ajo e SASPAC dhe ajo tatimore. S’janë bërë akoma të rejat.

Znj. Juliana Hoxha – tatim-taksat janë përpjekur të gjejnë një zgjidhje inovatore për këtë periudhë tranzitore dy-vjeçare, që nuk ka funksionuar. Një ndër to është *detyrimi ligjor për të ndryshuar librat e shitjes së biznesit*, dhe kjo gjë nuk ka ndodhur. Kam frikën që deri sa ky udhëzim të hyjë në fuqi, dhe librat e shitjes nuk ndryshojnë, nuk do ketë asnjë biznes që të marrë riskun përsipër që të lëshojë faturë dhe ta regjistrojë jo në librin e duhur. E kemi ngritur në të gjitha korrespondencat me Ministrinë e Financave, dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse duhet t’i japim patjetër biznesit sigurinë e operimit, s’mund të digjet biznesi.

Sepse për aq kohë sa biznesi s'ka sigurinë e tij tatimore, mund të tërhiqet fare, dhe kjo është edhe e drejtë nga pikëpamja e tij. Kështu që libri i shitjeve duhet të hyjë në fuqi.

Znj. Enkeleda Kuçi - Librat e shitjes dhe të blerjes, të paktën formatet, janë të miratuara dhe ndryshuara me kohë, kjo që thoni mund të jetë çështje sistemi.

Znj. Juliana Hoxha – po janë në VKM por nuk janë të aksesueshme, pra biznesi s'i përdor dot. Edhe gjëja e fundit, që është elefanti në dhomë. Nëse ky udhëzimi hyn në fuqi nesër, pyetja është: Çfarë ndodh me tvsh e akumuluar në këto vite nga ana jonë?

Znj. Eridana Çano - Do shkoni tek tatimet dhe do kërkonti rimbursimet. Mund të dëgjojmë edhe tatimet tani t'ju sqarojnë meqë janë të pranishëm. Ky udhëzim që pritet të dalë do mbulojë edhe periudhën tranzitore deri në daljen e udhëzimit të ri.

Znj. Juliana Hoxha - jo kjo nuk ka ndodhur, ne kemi qenë dhe kjo gjë ska ndodhur. Pra këtë proces e kemi bërë por s'ka funksionuar. Nga dalja e udhëzimit të marsit 2023, deri në daljen e të riut, si do proçedojmë?

Znj. Eridana Çano – do shkoni tek tatimet, do paraqisni gjithë dokumentacionet, dhe do ju rimbursohet. Periudha tranzitore, pra nga 2023 e deri sa të dalë udhëzimi i ri, do të rimbursohet dhe nuk do dalë me tvsh 0, dhe do shkoni tek tatimet dhe do rimbursoheni.

Znj. Juliana Hoxha – por kjo gjë nuk është e specifikuar në udhëzim, dhe duhet thënë patjetër.

Znj. Eridana Çano – me të gjitha rastet kur projektet janë projekte ministrie, ato do të parashikohen si kosto lokale që do mbulohen nga Ministria.

Znj. Juliana Hoxha – tani në momentin që hyri udhëzimi i ri, qeveria nuk e lejon më këtë. Nuk ka më projekte të ndihmës së huaj që ankorohen në ministri. Marrim për shembull “EU for Innovation”, “Challenge Fund”, nuk po them shifrën e tvsh së akumuluar

Znj. Eridana Çano – do ta paguaj Ministria shifrën përkatëse, sepse këtë gjë do ta parashitë tek ky udhëzim. Gjithsesi ky është një diskutim që duhet ta bëjmë ne mes nesh dhe njëherë për ta mbyllur. Përderisa ministritë po përdorin mundësitë e tyre për “local cost”, për të mbuluar rimbursimet, nuk shoh asnjë arsye pse të mos bëhet edhe në këtë rast megjithatë do ta diskutojmë.

Znj. Mirela Arqimandriti – ky udhëzim kur hyn në fuqi? Për shembull, projektet që kanë filluar në tetor apo që janë në punë e sipër a futen në këtë periudhë tranzitore?

Znj. Eridana Çano – periudha tranzitore do të jetë nga momenti i udhëzimit të parë, i cili nuk funksionoi, e deri tek ky udhëzim i ri që do jetë i përmirësuar, dhe shpresojmë të zgjidhi shumë nga problematikat, aty me udhëzim jemi me 0, të tjerat do jenë me rimbursim dhe do shihen rast pas rasti çfarë duhet të rimbursohen nga institucionet. Diskutimin e kemi prap me tatimet.

Znj. Juliana Hoxha – kjo çështja e rimbursimit të tvsh është shumë e rëndësishme për ne, sepse pjesa e borxhit të akumuluar është shumë e lartë. Unë jam zbatues e BE-së, nuk bëhet fjalë për projekte me ministri.

Znj. Eridana Çano – pra e ke çështjen të lidhur drejtpërdrejtë me tatimet. Do çosh faturat dhe do jua ribursojnë.

Z. Gentian Çeçe – A keni bërë kërkesë për rimbursim?

Znj. Juliana Hoxha – Jo nuk kemi bërë.

Z. Gentian Çeçe - Logjika është e thjeshtë - ka një angazhim që është thënë për projektet IPA III që janë pjesë e këtij udhëzimi që fillojnë nga 2023 e këtej dhe nuk kanë qenë të iniciuara më përpara 2023, pra tatimet do marrin angazhim që të trajtojnë çdo kërkesë që do u shkojë për rimbursim. Dhe ky është qendrim institucional.

Znj. Juliana Hoxha - kjo nuk ka ndodhur, jo më larg se para disa ditësh na u lajmërua nga SIDA na u tha që të kontaktonim tatim taksat.

Znj. Eridana Çano - Pra ju vazhdoni merrni komente nga kolegë të rastësishëm të tatimeve, dhe nuk bëni procedurën formale që duhet ndjekur?

Znj. Juliana Hoxha - Nuk është kolege e rastësishme është drejtoreshë e tvsh. Dhe nuk kam çfarë procedure të ndjek kur mua më thonë që nuk kam udhëzim për të bërë këtë gjë. Dhe unë flas në rrugë zyrtare me përfaqësuesit.

Z. Gentian Çeçe – Aplikoni njëherë pastaj do e shqyrtojmë nëse ju thonë jo.

Znj. Jetmira Hysenaj – të sqaroj vetëm një gjë në lidhje me rimbursimin – *nuk mund të zbatohet procedura e rimbursimit të tvsh sepse më kërkohen një sërë dokumentash të cilat nuk i kam.* E para, certifikatën që sipas procedurës së rimbursimit e marr në fund të projektit, pra të cilën nuk e kam, e dyta nuk kam certifikimin e shpenzimeve nga donatorë që sërish ndodh në fund të projektit – pra unë nuk e zbatoj dot procedurën e rimbursimit, sepse nuk marr dot këto dokumenta.

Znj. Juliana Hoxha – pjesë e procedurave tranzitore, nuk është vetëm kërkesa për rimbursim për tvsh, por kërkohet psh një procedurë e “tretë” që është midis procedurës së rimbursimit dhe kushteve aktuale, sepse të gjitha kërkesat për rimbursimin e tvsh sipas procedurës së vjetër nuk i bëjmë dot, nuk janë funksionale.

Çertifikimi i shpenzimeve nga BE ka qenë një mega investim një vit e gjysëm ka ngelur udhëzimi sepse ne ndërkohë duhet të lëshonim një copë letër që s’e kishte BE-ja procedurë, dhe ne sot marrim një copë letër ku thuhet, projekti u mbyll, këto ishin shpenzimet kjo ishte tvsh-ja. Tani, si ta marr unë nga projekti këtë letër në mes të projektit nga delegacioni, ska procedure.

Z. Gentian Çeçe – ne nuk kemi drejtoreshë tvsh-je. Mund të keni folur ndoshta me ndonjë inspektore që do bëjë praktikën tuaj. Unë di që për zbatimin e udhëzimit, ne si DPT kemi marrë angazhim që për pjesët e projekteve të IPA III dhe që janë në kushtet e udhëzimit që po diskutohet sot, si kërkesa e rimbursimit do të trajtohen. Pra kështu është diskutuar dhe vendosur.

Znj. Juliana Hoxha – nuk kam mundësi t’i përgjigjem kërkesave të ligjit, sepse më kërkojnë dokumenta dhe certifikime që duhet të japë donatori dhe nuk i jep dot.

Znj. Eridana Çano – në rregull do ta ridiskutojmë, do flas me Ministrinë e Financave, Drejtorin e përgjithshëm të tatimeve dhe Drejtorin rajonal të Tiranës për ta marrë si shembull për të gjitha drejtoritë e tjera rajonale, për të parë si është procesi çfarë na duhet etj. Faleminderit që e ngritët si shqetësim sepse këtë pengesë nuk e dinim.

Znj. Denada Seferi - edhe nëse keni diçka tjetër që nuk e adresuat sot në mbledhje, udhëzimin e keni, një koment dhe ja drejtoni Sekretariatit Teknik tek AMSHC, të cilët mund t'i mbledhin dhe t'ja kalojmë strukturave përkatëse.

Znj. Eridana Çano - Për të mirë të punës dhe që vitin e ri ta nisim me këmbë të mbarë, unë do doja që këtë udhëzim ta mbyllim deri në fund të këtij muaji. Nuk na mbeten edhe shumë ditë nëse ka komente ekstra ju lutem të na i nisni sa më shpejt komentet.

Znj. Denada Seferi – mbledhjen e deklaroj të mbyllur! Faleminderit!